

Republika e Shqipërisë

Ministria e Brendshme

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokokastër

Unioni i Gazetarëve të

Shqipërisë

Dega Gjirokokastër

Marrëveshje Bashkëpunimi

Objekti: ***Krijimi i një komunikimi të vazhdueshëm mes Zyrës për Mardhëniet me Publikun në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Gjirokokastër dhe gazetarëve gjatë procesit elektoral dhe atë zgjedhor në zgjedhjet e 28 qershorit në rajonin jugor.***

Për dijeni: Ministrit të Punëve të Brendshme Zotit Bujar Nishani, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Zotit Ahmet Prençi, Zyrës Rajonale të OSBE Gjirokokastë, Vëzhguesëve ndërkombëtarë të akredituar në Rajonin Jugor.

Unioni i Gazetarëve të Gjirokastrës, vëren me kujdes përpjekjet e Policisë së Shtetit, për të qenë pjesmarrëse aktive në plotësimin e standarteve të zgjedhjeve të 28 qershorit. Pjesmarrja e Policisë së Shtetit për të përmbushur standartet demokratike të këtyre zgjedhjeve duke luajtur një rol tërësisht asnjës në këtë proces përveçse ndihmues, dëshmon qartësisht në një angazhim total të të gjitha strukturave të saja përfshirë këtu edhe uniformat blu të Policisë së Gjirokastrës.

Unioni i Gazetarëve të Gjirokastrës si organizata më e fuqishme në vend dhe me njohje dhe bashkëpunim ndërkombëtar, dëshiron të luajë një rol aktiv gjatë zgjedhjeve të 28 qershorit duke qenë tërësisht asnjës dhe larg prirjeve partiake ndërkohë që kërkon po të njëjtin qëndrim edhe nga Policia e Gjirokastrës.

Unioni i Gazetarëve të Gjirokastrës, kërkon një bashkëpunim të efektshëm me Drejtorinë e Policisë së Qarkut të Gjirokastrës në lidhje me dhënien e informacioneve interaktive duke implementuar për të parën herë një formë të re komunikimi mes institucioneve shtetërore dhe të pavarura, dukuri që haset sot në vendet e zhvilluara përmes kanaleve të ndryshme qofshin këto në mënyre mobile, online dhe përmes daljeve nëpër konferencat për shtyp.

Unioni i Gazetarëve të Gjirokastrës, kërkon nga Policia e Gjirokastrës, krijimin e të gjithë hapësirave të nevojshme për marrjen e të gjitha informacioneve që kanë të bëjnë me rendin, zhvillimin e procesit zgjedhor në ditën e zgjedhjeve, rolin e policëve në terren, zgjidhjen e konflikteve të mundshme në terren si dhe informimin real të të gjithë ngjarjeve që mund të ndodhin.

Njëherazi kërkohet nga Zyra për Mardhëniet me Publikun që të organizojë periodikisht një herë në javë deri në përfundimin e të gjithë procesit zgjedhor

konferenca shtypi duke ardhur në rritje organizimi i tyre për t'u kulmuar në ditën e zgjedhjeve në intervale të shpeshta. Kjo praktikë e huazuar nga eksperiencat e tjera në vendet e zhvilluara, do të qartësojë dhe do të hedhë poshtë çdo lloj insinuate të lindur nga forca të ndryshme politike në ditën e zgjedhjeve për t'u përdorur si alibi.

Njëkohësisht kërkojmë nga Policia e Gjirokastrës, të na krijojë lehtësira në marrjen e informacioneve online dhe shkëmbim interaktiv të tyre me përfaqësuesin legjitim të informimit me publikun përmes teknologjive mobile "free" vetëm për gazetarët.

Unioni i Gazetarëve të Gjirokastrës, do të vërë në dispozicion të Zyrës për Mardhëniet me Publikun në Drejtorinë e Policisë së Qarkut të Gjirokastrës, të gjithë kapacitetin informues tek mediat lokale, qendrore dhe ndërkombëtare për të gjitha deklaratat zyrtare të dala nga ky institucion.

Unioni i Gazetarëve të Gjirokastrës, do të mbështesë Policinë e Gjirokastrës për denoncimin e të gjitha fenomeneve që do të çenojnë sadopak procesin para dhe paszgjedhor si dhe çënimin fizik të punonjësve të policisë nga faktorë të ndryshëm pasi në këtë kuadër uniforma e punonjësit të policisë është e paprekshme aq sa edhe privatsia e individit nga uniformat blu.

Lidhur me këto kërkesa të Unionit të Gazetarëve :

Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastrës, merr përsipër të plotësojë kërkesat legjitime të të gjitha medimeve që operojnë në jug të vendit dhe jo vetëm kaq, për informimin në bazë të detyrimeve që përcakton Kushtetuta e Shqipërisë dhe Ligji për Policinë e Shtetit .

Drejtoria e Policisë së Qarkut të Gjirokastrës përmes Zyrës për Marrëdhëniet me Publikun, do të jetë në shërbim të mediave dhe përfaqësuesve të tyre si deri më sot, me qëllim përcjelljen e informacioneve objektive dhe larg kahjeve politike të karakterit tërësisht zyrtar me qëllim informimin e opinionit publik në lidhje me veprimatrinë e Policisë para, gjatë dhe në përfundim të procesit zgjedhor, por dhe në vazhdimësi.

Do të krijojë të gjitha lehtësirat për komunikimin e medais me Zëdhënësin gjatë procesit zgjedhor , në marrjen e informacioneve online dhe shkëmbim interaktiv të tyre me përfaqësuesin legjitim të informimit me publikun përmes teknologjive mobile "free" vetëm për gazetarët.

Ndërkohë Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastrës, është tërësisht e angazhuar të luajë një rol të rëndësishëm në plotësimin e të gjitha standarteve të kërkuara

duke krijuar një klimë besimi tek zgjedhësit dhe mediumet e ndryshme në fushatën para, gjatë dhe paszgjedhore.

Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastrë nëpërmjet kësaj marrëveshje bashkëpunimi garanton Përfaqësuesit e Medias, Opinion publik,Subjektet Elektorale , Përfaqësuesit Ndërkombëtarë se :

Strukturat policore të kësaj Drejtorie do jenë tërësisht në funksion të zbatimit të ligjit dhe vetëm të ligjit , duke treguar profesionalizëm, paanësi, korrektësi gjatë gjithë procesit zgjedhor dhe transparencë të plotë në lidhje me rolin dhe veprimtarinë e policisë në zgjedhje .

Do garantojmë rendin e qetësinë në të gjitha aktivitetet elektorale që do të zhvillohen në qarkun tonë dhe krahas kësaj detyre kaq të rëndësishme do të vazhdojmë me zero tolerancë luftën kundër krimit të Organizuar dhe krimit në përgjithësi.

**Drejtori i Policisë së Qarkut
Gjirokastrë**

Drejtues i Parë Arben HYSENI

**Unioni i Gazetarëve të Shqipërisë
Dega Gjirokastrë**

Kryetari

Piro Nase